



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 24.5.2016, ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaku dhe Jelena Bontiq.

Munguan: Alma Lama, Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë: Anëtarët e Bordit të RTK-së, përfaqësuesja e Zyrës së BE-së, OSBE-së, NDI-së KDI-së, BIRN, RTV 21, Koha ditore.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2015;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-099, për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**  
Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2015;**

**Zenun Pajaziti**, para se të fillojë me pikën e dytë të rendit të ditës, i njoftoi anëtarët e Bordit të RTK-së, se nuk është pikë e rendit të ditës çështja e pronës së RTK-së dhe për shqetësimet e tyre në lidhje me vendimin e Agjencisë së Privatizimit për lirimin e pronës së RTK-së, bordi i RTK-së të komunikojë me AKP-në, në mënyrë institucionale deri në nxjerrjen e një vendimi të Kuvendit të Kosovës. Ai tha, se nuk do të lejohet që punëtorët e RTK-së të mbesin në rrugë, pa objekt dhe është në përgjegjësinë e bordit të menaxhojnë me pronën dhe më pas ia dha fjalën kryetarit të Bordit të RTK-së, i cili paraqiti Raportin vjetor të punës së RTK-së, për vitin 2015.

**Ismet Bexheti**, tha se raporti është punuar konform standardeve profesionale, me qëllim të ruajtjes së balancës programore, RTK-ja e ka ruajtur besueshmërinë dhe shikueshmërinë, e këtë e dëshmojnë hulumtimet që janë bërë dy herë brenda vitit 2015.

Bordi i RTK-së në bashkëpunim me menaxhmentin, ka hartuar rregullore të reja dhe i ka plotësuar ato në fuqi. Në planin e veprimit për funksionalizimin e mëtejshëm, RTK-ja ka arritur rezultate në gjashtë muajt e fundit të vitit 2015, duke mos e përjashtuar nevojën për rritje të transparencës dhe platformave të reja, të cilat nuk po mundemi t'i arrijmë në mungesë të mjeteve financiare.

Gjithashtu, raporti përfshinë edhe pjesën shtesë –financiare.

**Sadri Ferati**, pyeti për gjendjen financiare në RTK-së, me përjashtim të borxheve të trashëguara.

**Xhevahire Izmaku**, theksoi se raporti i vitit 2015, është raport i hartuar në kohën më të vështirë të ekzistencës së RTK-së, për arsye të mosqëndrueshmërisë financiare të RTK-së, e sidomos tani edhe të vendimit të AKP-së për lirimin e objektit të RTK-së. Ajo tha se e konsideron të ngutshëm vendimin dhe mënyrën e qasjes së AKP-së ndaj RTK-së.

Sa i përket raportit, është bërë punë e mirë në përmbushjen e rregullativës ligjore, nxjerrjen e akteve nënligjore.

Ajo nuk u pajtua tek pjesa e raportit, sfidat e RTK-së, që për çështjen financiare Kuvendi nuk ka e kryer punën dhe pati vërejtje për emisionet e mëngjesit në RTK dhe emisionin “Imazh”. Izmaku propozoi plotësimin e emisioneve edukativo-arsimore. Lidhur me pronën e RTK-së, ajo kërkoi që Kuvendi dhe Qeveria të vendosin me ligj për pronën dhe qëndrueshmërinë financiare.

**Kujtim Paçaku**, pyeti rreth ndarjes së mjeteve financiare për minoritete, sipas nenit 8.3 të ligjit në fuqi dhe a ka planifikuar RTK-ja të ndajë minutazhin në gjuhën romë në emisionin e radios?

**Sadri Ferati**, tha se pjesa e raportit për pjesën programore është e përgjithësuar, pa detaje për sfidat, ndërsa që ende Komisioni nuk ka përgjigje për shpenzime rentabile, dhe cilat kanë qenë trendet e kursimit, në këtë fazë kur RTK-ja trashëgon borxhet. Cilat opsione RTK-ja i ofron për gjetjen e formave për një qëndrueshmëri financiare?

**Mentor Shala, drejtor i përgjithshëm i RTK-së**, u përgjigj në pyetjet e z. Ferati, duke thënë se raporti sa herë që adresohet në Kuvend keqpërdoret nga deputetë të partive të ndryshme politike, në kuptimin se nuk është parimore që deputetët të japin vlerësime rreth politikave editoriale dhe pikërisht kjo konsiderohet ndërhyrje politike, sepse ligji për RTK-në nuk e parasheh në asnjë nen miratimin e raportit nga Kuvendi dhe nuk është obligim ligjor, sipas ligjit, Kuvendi të

miratojë raportin, vlerësimet e deputetëve për emisionet e RTK-së se cilat janë më të mira e cilat jo, natyrshëm janë presion politik, këto janë parimet e gazetarisë.

Lidhur me bilancin e të hyrave dhe shpenzimeve, është raporti i auditorit të përgjithshëm me pasqyra financiare, ndërsa sa i përket ndarjes së 15% të buxhetit për komunitete kjo përmbushet plotësisht. RTK-ja është i vetmi transmetues publik që transmeton emisione në gjuhën e komuniteteve dhe RTK-ja është transparente konform ligjit.

Gjithashtu, sa i përket propozimeve për plotësim-ndryshimin e ligjit në fuqi, rreth gjetjes së mënyrës për qëndrueshmëri financiare, RTK-ja ka përcjellë propozimet në Kuvend, por nuk ka vullnet politik për çështjen në fjalë.

**Naim Gashi, anëtar i Bordit të RTK-së,** tha se në bord edhe pse ka mendime ndryshe ka edhe respekt për fjalë ndryshe, fatkeqësisht në raport me menaxhmentin nuk e kemi këtë mirëkuptim edhe pse ai personalisht kishte kërkuar llogari nga menaxhmenti për parregullsitë e vërejtura, ai ishte akuzuar nga drejtori i përgjithshëm se është interfolësi i deleguar nga Kuvendi për të shkatërruar RTK-në.

Shqetësimet e tij ishin rreth monitorimit të raportit nga Kuvendi, si themelues i RTK-së, si dhe shqetësimet në raportet menaxhment – bord, rreth zbatimit selektiv të vendimeve të bordit nga menaxhmenti, duke dëshmuar se raporti vjetor, i cili po shqyrtohej, nuk është miratuar në bord dhe as që është proceduar për votim, me gjithë vërejtjet e cekura me shkrim.

Kërkesa e tij për komisionin ishte, që të kërkohet nga menaxhmenti i RTK-së, lista e pagave e të punësuarve, me faktin se kjo listë nuk i është dhënë bordit edhe pse është kërkuar nga menaxhmenti, ndërsa që ka diskrepancë të madhe milionëshe, në raportet e auditorit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Në raport shihen pozicionet buxhetore për investime kapitale, barten në investime për paga, ndërsa që menaxhmenti nuk ka plane për tejkalimin e borxhit dhe gjetjen e formave për qëndrueshmërinë financiare.

Sa i përket ndikimit të politikës në RTK, në raportin e progresit ceket për njëanshmërinë politike të RTK-së.

**Mentor Shala,** tha se ato që u thanë nga parafolësi nuk qëndrojnë, ndërsa që në numrin e punëtorëve përfshihen edhe të punësuarit me kontrata mbi vepër.

**Xhevahira Izmaku,** tha se komisioni në kuadër të fushëveprimtarisë së vet, ka të drejtë të vlerësojë performancën e RTK-së dhe nuk i konsideron ndërhyrje politike vlerësimet e deputetëve.

**Zenun Pajaziti,** pyeti kryetarin e bordit, se a është miratuar raporti vjetor nga Bordi?

**Ismet Bexheti,** kryetar i bordit, u përgjigj, duke thënë se raporti është shqyrtuar në bord dhe i është kthyer menaxhmentit me vërejtjet e bordit për plotësime shtesë.

Konstatim: Komisioni vendosi që miratimi i Raportit vjetor të RTK-së, të shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit.

**3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-099, për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011;**

Komisioni pasi diskutoi rreth propozimit të Komisionit Evropian, për procedimin e Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, me shumicë votash nxori rekomandimin si në vijim:

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56 paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24.5.2016, shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 05/L-099 për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë:

**R e k o m a n d i m**

1. Të miratohet në parim Projektligji nr.05/L-099 për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011;
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

**Arsyetim**

Në bazë të nenit 56 paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL shqyrton Projektligjin në parim, para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit nr. 05/L-099, për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në komunat e Kosovës, që nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, vlerësojë se Projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Mbledhja përfundoi në orën: 15:00.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

-----  
**Zenun Pajaziti**